

Ndërtimtaria kryesore

Sigurohet pensionimi me 60 vjet

2

Dita ndërkombëtre e gruas

Të mbrojmë pensionet përmes AHVplus!

3

Shiptaro-zviceranët e Zvicrës lindore

Model i pjesëmarrjes aktive politike e shoqërore

4

Nr. 1 | shkurt 2016 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Votimi m+e 28 shkurt: Iniciativa mbi zbatim-dëbimin

Initiativa që kriminalizon të gjithë migrantët

Më 28 shkurt në Zvicër do të votohet përsëri. Gjithsej do të votohet për katër projektligje. Ndër to është edhe iniciativa ksenofobe, e ashtuquajtura «iniciativë mbi zbatim-dëbimin» e SVP-së. Kjo përcakton se si duhet vepruar kundër të huajve kriminal. Në të vërtetë ajo paraqet sulm kundër të gjithë migrantëve në Zvicër. Ajo atakon edhe shtetin ligjor dhe të drejtat e garantuara njerëzore në Zvicër, pasi këto ç'fuqizohen në raport me migrantët.

Me shumë para të marra nga sigurimet sociale? Dëbim!

A e keni mbushur ndonjëherë një formular mbi sigurimet shoqërore gabimisht dhe për këtë arsye keni marrë më shumë para se ju takojnë? A njihni dike që nuk i ka deklaruar arkës së sigurimit të papunësisë fitimin nga puna anësore? Nëse iniciativa mbi zbatim dëbimin (IZD) aprovohet nga populli zviceran më 28 shkurt, atëherë ju apo të njohurit tuaj do të dëbohen. Pasi këto shkelje qëndrojnë në IZD, bashkë me krimet e rënda, si gjenocidi, vrasja dhe përdhunimi, po në të njëjtin katalog, në bazë të cilit ndodh dëbimi automatik i menjëhershëm. Pa të drejtë dëgjimi ligjor dhe pa vërtetim faktesh apo ankesë.

Kjo IZD atakon edhe sekondat

A ka në rrethin tuaj të rinj, të cilët kanë bërë ndonjë marrëzi? Shembulli bie kanë thyer një shitore, kanë

JO iniciativës mbi zbatim dëbimin!

A keni punuar disa ditë pa e informuar sigurimin e papunësisë?

! DËBUAR!

Ti themi të gjithë së bashku JO kësaj padrejtësie! Flisni për këtë me kolegët dhe të njohurit Tuaj. Më 28 shkurt: JO Iniciativës mbi zbatim dëbimin!

UNIA

Ftesa për të votuar kundër iniciativës famkeqe mbi zbatim dëbimin

dëmtuar derën dhe kanë vjedhur një gajbe me birra si provë guximi? Kanë spërkatur (me sprej) muret e shtëpive? Kanë kultivuar hashash apo kanë poseduar drogë? Të gjitha këto delikte qojnë në dëbim.

Me këtë IZD sekondat, që kanë lindur e janë rritur këtu, që janë në shtëpi këtu, edhe për delikte të tilla të imta do të dëbohen. Kështu ata për të njëjtat marrëzira sikur edhe të rinjtë tjerë do të dënohen shumë më rreptë dhe me konsekuenca të pa parapara se sa koleget e kolegët e tyre e pasaportë zvicerane. Dhe se do të dëbohen në një vend, të

cilin e njohin vetëm nga pushimet vjetore, nuk luan ndonjë rol. Ashtu sikur nuk luan ndonjë rol që ata janë lindur e rritur këtu, se këtu kanë edhe shokët e shoqet, familjen dhe qendrën e tyre jetësore. Përshtatshmëria e dënimit nuk mund të verifikohet dhe vendimi nuk mund të kundërshtohet.

Sulm parimeve të shtetit ligjor

Iniciativa për zbatim-dëbimin atakon edhe rregullimin juridik zviceran, ajo është në kundërshtim me parimet bazë të kushtetutës zvicerane

ne dhe ç'fuqizon të drejtat e njeriut. Me këtë iniciativë dhe diskursin e saj ksenofob Partia Popullore e Zvicrës (SVP) don të zbatojë programin e saj politik. Një program ky, i cili është orientuar kundër migrantëve, gjyqtarëve dhe parlamentit, lirisë dhe solidaritetit. Një program që nuk është në përputhje me demokracinë. Si duket SVP-ja me politikën e saj dëshiron të ç'fuqizoj të gjitha rregullat demokratike. Andaj vlen që këtë iniciativë ta luftojmë me të gjitha forcat. Ajo nuk është një sulm vetëm kundër migrantëve e migrantëve por kundër të gjithë banorëve të Zvicrës.

Projektligjet tjera

Më 28 shtator do të votohet edhe për projektligje tjera. Bashkimi i Sindikatave Zvicerane dhe Unia rekomandojnë një JO të qartë mbi iniciativën e CVP-së «ndëshkimi i martesës» si dhe mbi tubën (tunelin) e dytë në Gotthard. «Ndëshkimi i martesës» është një iniciativë e prapambetur dhe e panevojshme, nga e cila përfitojnë vetëm qiftet e pasura bashkëshortore. Një PO për tubën (Tunelin) e dytë në Gotthard domethënë që miliarda franga të investuara në NEAT, sikur janë të djegura tërësisht. NEAT është prova për të bartë komunikacionin rrugor nga Gotthard-i në binarë treni. Andaj një PO do të ishte shkatërrimtar. Ndërsa një PO rekomandohet për «Iniciativën për stopimin e spekulimit». Ajo dëshiron që për shembull bankat të mos spekulojnë më para për mallra bujqësore apo për dyqane ushqimore. Me ushqim nuk luhet!

» Marilía Mendes dhe Aurora García

Editorial



Të dashur/a lexues/e

Ne po e fillojmë vitin ashtu, sikur edhe e kemi filluar: me mijëra refugjatë, të cilët ikin nga tmerri në vendet e tyre për në Evropë. Mirëpo në Evropë janë duke u grindur, se si mund të mbrohen më mirë nga kjo «valë refugjatësh». Ekstremistët e djathtë janë në pushtet apo duke avancuar drejt pushtetit.

Duket sikur jemi duke u dorëzuar para frikës. Shumë veta mendojnë, refugjatët po na marrin të gjitha. Të mos lejojmë që të na manipulojnë disa media dhe politikan: Nëse ne i shikojmë gjërat në mënyrë njerëzore dhe të arsyeshme, ne mundemi shumë mirë ti absorbojmë të arratisurit, dhe atë pa pasur frikë nga papunësia apo çfarëdo tjetër. Kufijtë dhe politika represive nuk do të mund të zgjidhin asnjë nga sfidat tona e aq më pak ti ndalojnë refugjatët.

Frika qon vetëm tek represioni dhe diktatura në emër të «sigurisë», dhe e kaluara na ka treguar se çka ndodh: Vdekje, mjerim, dhimbje, padrejtësi, pasurim të pakicës. Të kemi parasysh Gjermaninë e Hitlerit, apo diktaturat e së kaluarës dhe së tashmes në tërë botën. A duam me të vërtetë të shkojmë kësaj rruge? Të kthejmë rrotën mbrapa?

Ne kemi nevojë për një politikë të re migracioni në vend të frikës. Rrugë të sigurta për refugjatë: Gjetja e sistemeve, për të njohur e pranuar çoftë edhe vetëm pjesërisht kualifikimet e migrantëve; investime më të mëdha në arsim dhe trajnime. Paratë nuk do të mungonin, nëse ne më pak miliarda do të investonim në ushtri dhe të ofronim më shumë arsimim për të gjithë! Ne do të na duhej vetëm gatishmëria që të përballemi pa frikë me sfidat – dhe që të mos lejojmë që frika të dominojë mbi njerëzoren. Të jemi solidar – nesër mund të jemi ne ata, të cilët ikin.

Aurora García

Drejtuuese e sektorit për migracion


SI TË VOTOJMË?



Hapni zarfin e transmetimit



Shkruani (JO) NON apo NEIN në fletën e votimit



Vendoseni fletën e votimit brenda zarfit anonim të votës dhe mbylleni atë



Firmoseni kartën e legjitimitetit që ndodhet brenda zarfit të transmetimit



Vendoseni zarfin anonim të votës së bashku me kartën e legjitimitetit brenda zarfit të transmetimit, duke e mbyllur përsëri atë



Dërgoni zarfin e transmetimit brenda datës 20 shkurt me anë të postës ose çoni votën tuaj deri më 24 shkurt në kutinë postare të Komunes

News

Unia edhe më tej duke u rritur



Unia është rritur edhe në vitin 2015: Në fund të vitit 2015 Unia numëroi 201.164 anëtarë, ose 0.7% më shumë se sa një vit më parë. Kështu Unia si sindikata më e madhe e Zvicrës u rrit për 5 vjet rresht. Anëtarësi u shtua kryesisht në sektorin e profesioneve të shërbimeve (+3.8%), në artizanat (1.1%) si dhe në sektorin edhe ashtu të organizuar mirë të ndërtimitarisë (+0.8%). Edhe pjesa e grave është rritur përsëri (+0.5% në gjithsej 24%)

Gjeneva e vendosur kundër dumpingut në paga



Dumpingu në paga është një problem gjithë zviceran. Tani pas Kantonit Basel-Land edhe Gjeneva përmes Këshillit Komunal ka vendosur masa adekuata, për të luftuar keqpërdorimet. Kështu qyteti i Gjenevës bashkë me sindikatat dhe punëdhënësit janë pajtuar për të zbatuar praktikën me rastin dhënies së mandateve publike. Kjo marrëveshje shkon edhe më larg se sa rregullat e parapara me ligjin federal. Përmes kësaj ndalohen rrjetet e nën-ndërmarrjeve, cakton dënime më të larta dhe krijon një fond social në rast të mungesës së pagave.

Karta e migracionit kërkon liri leje qëndrimi

Në gjysmën e parë të vitit 2015, teologët e majtë katolik dhe të reformuar kërkuan një politikë solidare të migracionit, duke pasur parasysh numrin e madh të refugjatëve, të cilët provojnë të arrijnë në Evropë. Në një lloj «Karte Migracioni» kërkohet posaçërisht «liria e leje qëndrimi për të gjithë» dhe më shumë angazhim të kishave. Më 23 janar 2016 u takun rreth 330 pjesëmarrës nga rrethet kishtarë dhe të OJQ-ve, për të diskutuar mbi temën «Mirë se vini në një shoqëri solidare». Edhe Unia ishte në këtë takim, me ç'rast ajo kërkoi kushte të sigurta pune për të gjithë, në vend të kontrolleve të migracionit dhe pa përkeqësime dhe ilegalitet. Në tribunën përfundimtare të takimit të pranishmit vendosën të iniciojnë themelimin e «Rrjetit të solidariteti në Zvicër» si dhe të krijojnë parakushte për thellim shkencorë dhe politike të konceptit të lirës së leje qëndrimi.

Ekonomia e ndërtimitarisë kryesore, KKP

Angazhimi i shpaguear: sigurohet pensionim me 60 vjet!



Pamje nga protsta e vitit të kaluar të punëtorëve të ndërtimitarisë

Shoqata Zvicerane e Punëdhënësve dhe sindikatat Unia e Syna janë pajtuar për Kontratën Kombëtare të Punës për Ndërtimtarin e cila vlen nga fillimi 2016 deri në fund të vitit 2018. Ajo pëson pak përshtatje. Pos tjerash është siguar pensionimi me 60 vjet pa reduktime përfitimsh.

Delegatët e Shoqatës së Punëdhënësve të Zvicrës dhe sindikatat Unia e Syna në fillim të dhjetorit 2015 në Oltën janë pajtuar mbi Kontratën Kombëtare të Punës (LMV) për ndërtimtarin kryesor. Kjo kontratë ka hyrë në fuqi nga 1 janari 2016 dhe vlen deri

në fund të vitit 2018. Kontrata (LMV) e re përbën edhe ndalesën e pagesës e pagës kesh në dorë. Kështu partnerët social theksuan dëshirën e tyre, të përmirësojnë kontrollet. Kushtet dhe përfitimet e deritashme mbeten edhe më tej të vlefshme.

Organet vendimmarrëse thanë po

Rezultati i bisedimeve u vërtetua edhe nga mbledhjet e jashtëzakonshme si të delegatëve të sektorit përkatës të sindikatave Unia e Syna ashtu si edhe të atyre të Shoqatës së Punëdhënësve të Zvicrës. Të dyja palët janë tërhequr nga kërkesat e tyre fillestare, për të mundësuar rezultatin e bisedimeve.

Pagat dhe pensionet me 60 të siguruara

Pikat më e rëndësishme: pensionimi me 60 u siguroa! Për të siguruar pensionimin e deritashëm nga moshë 60 vjeç partnerët social u pajtuan që nga 1 qershori 2016 pagesa e kontributeve në fondin e pensionimit të parakohshëm (FAR) të rritet për dy pika përqindjeje. Nga kjo punëdhënësit marrin përsipër 1.5% ndërsa punëmarrësit aktiv 0.5%. Ndërsa i kundërshtojmë pagat për vitin 2016 mbesin të pandryshuara. Me rastin e raundeve të pagave që do të zhvillohen për vitin 2017 e 2018 kontributet e rritura nga ana e punëdhënësve do të përlllogariten, mirëpo maksimalisht për 0.5%. Nga viti 2017 kompensimi për drekë do të ngrihet nga 15 në 16 franga.

Mbeten hapur edhe disa pika

Bisedimet nuk janë përmbyllur tërësisht. Palët kontraktuese janë obliguar që të gjitha piket e hapura të negociojnë deri në mesin e vitit 2017.



Fitoni me Unia.

Këtu posaçërisht hynë edhe çështja e rregullave me rastin e motit të keq. Kjo me rastin e një ankete që Unia ka zhvilluar me punëtorët e ndërtimitarisë a dal si ndër problemet më të mëdha: mbrojtje e pamjaftueshme gjatë motit të keq. Një problem tjetër mbetet dampingu i pagave, i cili i takon përditshmërisë nëpër kantiere. Edhe këtu është e qartë se nevojitet një zgjidhje.

Palët negociuese mund të anulojnë Kontratën në afat të rregullt më 30 shtator 2017, në rast se rezultatet e bisedimeve nuk janë të kënaqshme. Palët kontraktuese pos tjerash kanë dorëzuar kërkesën në Seco (Sekretariatit shtetëror për ekonomi) për të shpallur Kontratën (LMV) me vlefshmëri të përgjithshme.

Aurora Garcia



Motoja e sindikalitëve: Bashkë jemi ë të fortë!

Industri, shkarkime masive

Të ruajmë vendet e punës, të mbrojmë industrinë!

Tronditje e madhe në fillim të vitit: General Electric (GE)/ish-Alstom dëshiron të reduktojë 1300 vende pune. Të punësuarit dhe popullata e Kantonit Aargau nuk duan të pajtohen me reduktimin e komunikuar. Mbi 500 njerëz me 23 janar në Baden kanë kërkuar ruajtjen e vendeve të punës dhe kanë treguar solidaritetin e tyre me të punësuarit e industrisë zvicerane.

Porosia e demonstratës më 23 janar ishte e qartë: Komunikimi i GE për këtë kositje nuk është pranueshëm. Të punësuarit kërkojnë nga GE të ruajë vendet e punës në Aargau. Vendet e punës në industri tek ndërmarrja tradicionale Alstom janë më rëndësi të madhe për tërë regjionin dhe Zvicrën si vend-punishte. Sindikatat Unia dhe Syna kërkojnë vendosmëri për masa të nevojshme nga ana e politikës: «Industria na përket të gjithë neve. Ne nuk guxojmë të pranojmë de-industrializimin», thotë Christian Gusset, drejtuesi i degës së MEM (makinerisë, energjisë e metalit) në Unia. Ai thotë se është obligim i qeverisë së Aargau-t dhe



Në industri janë duke ndodhur shkarkime masive

qeverisë federale, që të kërkojnë ruajtjen e vendeve të punës nga ana e GE. Mathias Regotz, drejtuesi i sektorit të industrisë në sindikatën Syna, kërkon që krahas heqjes dorë nga reduktimi i panevojshëm financiar i vendeve të punës, edhe një strategji nacionale për industrinë. «Menjëherë nevojitet të ngrihet një grup pune nacional i përbërë nga përfaqësues të federatës e të kantoneve si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve e punëmarrësve.»

Kërkohet transparencë dhe përgjegjësi

Dyshimi është i bazuar se GE me reduktimin e vendeve të punës dëshiron të rritë në maksimum fitimin. Përfaqësuesit e të punësuarve të GE në nivel Zvicer, sindikata Unia dhe Syna si dhe shoqata «Angestellte Schweiz» (Punonjësit e Zvicrës) dhe shoqata e tregtarëve, bashkërisht kërkojnë heqje dorë nga reduktimet. Koncerni duhet të jetë transparent: Kush krejt është i rrezikuar? Cilët

sektor sipas dëshirës së GE duhet të bartet në vende tjera? Sindikalitet dhe shoqatat e punëmarrësve kërkojnë konkretisht që GE të heq dorë nga reduktimet dhe së bashku me Task-forcën (grupin punues) e krijuar (përbërë nga qeveria kantonale, përfaqësuesit e punonjësve, sindikatat dhe shoqatat e punëmarrësve) të përpunojnë zgjidhjet e mundshme, për të ruajtur në afatgjatë vendet e punës në Kanton Aargau.

Dështimi i politikës

Edhe dështimi i politikës bëhet i qartë me rastin e shkarkimeve tek GE. Janë të nevojshme përfundimisht masa konkrete për të siguruar dhe forcuar industrinë e Zvicrës. Vetëm një politik e vendosur mund të pengojë de-industrializimin e Zvicrës. Politika me këtë rast duhet të përfshijë të gjithë aktorët, të angazhohet për inovacion dhe të punësuar të arsimuar dhe të qëndrojnë e vendosur për Zvicrën si vend-punishte. Qeveria federale – veçanërisht kryetari federal Johann Schneider-Ammann – duhet më në fund të jetë më aktiv dhe të prezantoi një strategji të bindshme kundër de-industrializimit.

Aurora Garcia

Dita ndërkombëtare e Gruas, AHVplus

Të mbrojmë pensionet, po për AHVplus

Në ditën e sivjetme ndërkombëtare të gruas, 8-Marsin, gratë e Unia-s do të dalin në rrugë për iniciativën AHVplus. Pikërisht tani, ku bëhet fjalë mbi rritjen e moshës së pensionimit dhe vështirësitë financiare, ne duhet të sulmojmë!

Çdo vit Grupi i interesit (GI) të grave me 8 mars shënon ditën ndërkombëtare të gruas. Këtë vit aktivitetet do të zhvillohen në rrugë dhe nëpër ndërmarrje e vend-punishte dhe në qendër të vëmendjes do të kenë iniciativën AHVplus. Iniciativa AHVplus ka për qëllim që pensionet e pleqërisë në Zvicër të rriten për 10%. Konkretisht kjo domethënë 200 franga më shumë për të personat e vetmuar, ndërsa 350 franga për qifte bashkëshortore me shume se sa tani. Rritja e fundit substanciale e pensioneve të pleqërisë a ndodhur para 40 viteve! Koha e fundit pra për rritje të pensioneve.

Forcimi i AHV-AVS tani!

Viti 2016 është vendimtar për të ardhmen e pensioneve tona. Përmes përkujdesjes së pleqërisë 2020, e cila tani po diskutohet në Parlament, kërcënohet edhe me shkurtime. Në të njëjtën kohë kontributet në shtyllën e dytë janë të pasigurta dhe çdoherë duke u përkeqësuar. Përgjigjja jonë ndaj këtyre sulmeve kundër pensioneve tona është iniciativa AHVplus për të cilën do të votohet në shtator të këtij viti. Ne duhet të forcojmë shtyllën e parë shoqërore AHV-AVS!

AHV i ka punët mirë

Pasi edhe përkundër ngjyimeve të zeza AHV-AVS qëndron mirë financiarisht, andaj rritja e pensionit ashtu si e parasheh AHVplus është e mundshme. Kjo falë sistemit të qëndrueshëm të financimit të kësaj shtylle publike AHV-AVS. Sa më shumë që rritet prodhimtaria, pagat dhe numri i të punësuarve, aq më të larta janë të hyrat e saja. Ajo

financohet kryesisht nga përqindja e pagave. Pasi secili i punësuar aktualisht fiton dhe grumbullon se sa përpara, nevojiten gjithmonë e më pak të punësuar për të financuar pensionet e pleqërisë të shtyllës shoqërore. Ndaj AHV-AVS mund të përballojë mirë zhvillimet demografike.

Gratë posaçërisht të prekura

AHV-AVS është me rëndësi të veçantë për gratë. Pasi gratë në jetën e punës fitojnë konsiderueshëm më pak se sa burrat dhe kryejnë punët e shumta që janë pa pagesë, në pleqëri kanë pensione të ulëta – tepër të ulëta. Ato marrin shumë më trallë se sa burrat para nga shtylla e dytë. Pos kësaj gratë sipas planifikimeve reduktuese dhe përpjekjeve për rritjen e moshës së pensionit janë në mënyrë speciale të prekura.

➔ Aurora García

Andaj me 8 mars vlen: bëhuni pjesë e aktiviteteve në regjionin e juaj! Për një pension të mirë pleqërie dhe AHV-AVS të fortë!



Intervistë



Melanie Martin, drejtuese e projektit CareInfo.ch

Platforma për kujdestaret CareInfo.ch

Numri i të ashtuquajturave kujdesi i përhershëm i migrantëve, pra kryesisht grave, të cilat punojnë në kujdestarinë 24 orësh nëpër shtëpitë private, sa vjen e është duke u rritur. Andaj është me rëndësi, që edhe ko grup e punëmarrëseve të jetë e informuar mirë për të drejtat e tyre. CareInfo.ch është një faqe interneti, që kryen këtë punë informative. Momentalisht ajo është duke funksionuar vetëm në gjermanisht, polonisht dhe hungarisht. Ne kemi biseduar me Melanie Martin, drejtuese e projektit CareInfo.ch.

Nga kjo ide, për të themeluar këtë platformë?

Qendra profesionale për barazi e qytetit të Cyrihut ka vite që është aktive në lëmin «Kujdestari në shtëpi gjatë 24 orësh» (Care-Migrantinnen). Bashkë me profesionistë tjerë kjo qendër profesionale grumbulloi informatat dhe krahas kësaj ajo publikoi edhe një doracak këshillues për kujdestarinë në shtëpitë private. Ky doracak tregon se çka duhet pasur parasysh sa i përket aspektit ligjor, për tu ofruar kujdestareve të «Care-Migrantinnen» kushte korrekte pune. Doracaku këshillues mund të porositet falas në qendrën profesionale në fjalë. Përmes aktiviteteve të ndryshme dhe kontakteve u qartësua se vet «Care-Migrantinnen» kanë nevojë të madhe për më shumë informata mbi të drejtat dhe obligimet e tyre në Zvicër. Pasi që ato janë të lidhura shumë me punën e tyre të kujdestarisë në shtëpitë private e kanë të vështirë të shknë në takime apo tubime informative. Andaj qendra profesionale zhvilloi mundësinë e informimit pa marrë parasysh kohën dhe vendin: Faqe internetit CareInfo.ch.

Çka është Care Info? Çka posedon kjo faqe interneti?

CareInfo është një vendtakim dhe një platformë informative. Në këtë platformë bëhet informimi, posaçërisht mbi aspektet juridike si paga, pushimet, afatet e dorëheqjeve. Adresantët janë «Care-Migrantinnen» (kujdestaret që punojnë 24 orë nëpër shtëpitë private), mirëpo edhe personat që duan të punësojnë kujdestare në fjalë. Pos kësaj platforma ofron një forum shkëmbimi online për kujdestaret në fjalë.

Sa vizitore në muaj ka faqja e internetit?

CareInfo vizitohet prej rreth 500 personave në muaj. Këta janë në njërin anë janë persona që kërkojnë vetëm informata të caktuara. Në anën tjetër të tillë që vazhdimisht vizitojnë këtë faqe. Shembulli bie, në faqen e internetit mund të lexohen shkrimet e reja mbi temat aktuale, si mundësitë mbështetëse dhe financuese, Etika për kujdestarinë, Kontrata Normale e Punës, ekonomia shtëpiake apo përditshmëria e punës në «Care-Migrantinnen».

Si mund ta mbështet Unia dhe anëtarët e saj platformën?

Për CareInfo propaganda gojë më gojë është shumë me rëndësi, sikur vet kujdestaret ashtu edhe personat që duan të punësojnë kujdestaret në shtëpitë e tyre. Kjo konkretisht domethënë: Bisedoni me shoqe e shokë mbi CareInfo dhe njoftoni mbi faqen e internetit në fjalë mjekët e shtëpisë, shërbimet sociale, personelin e Spitex-it, etj. Pos kësaj mund të porositni falas edhe fletëpalosje tek CareInfo. Apo abonojeni shkrimet për të qenë të informuar rregullisht. Pos kësaj kantonet dhe qytetet kanë mundësinë të jenë sponsor e pjesë bartëse të CareInfo. Para së gjithash sponsorët do të kenë mundësinë që të plasojnë informata specifike kantonale në faqen e internetit. Kështu CareInfo do të informoi aty ku është nevoja.

➔ Adam Rogalewski

Kongres 2016 UNIA

Nga 27 deri më 29 tetor 2016 në Gjenevë, Palexpo

Thirrja e Kongresit të tretë të rregullt të sindikatës Unia

Mbledhja e delegatëve e sindikatës Unia më 5 dhjetor 2015 vendosi të thërras Kongresin e tretë të rregullt të Unia-s. Kongresi do të zhvillohet nga 27 deri më 29 tetor 2016 në Palexpo të Gjenevës.

Lista e pikave të rendit të ditës do të bëhen të njohura në qershor 2016. Tema e parapara kryesore do të jenë: Raporti i veprimtarisë dhe bilanci strategjik 2012–2016, synimet strategjike 2016–2020, dokumentet e pozicionimit mbi temat e veçanta politike të sindikatës dhe tema fanare (dritë-orientuese) «Solidare në shoqëri – e fortë nëpër ndërmarrje». Kongresi do të zgjedh edhe drejtorinë qendrore dhe anëtarët e kryesisë qendrore. Të drejtë aplikimi dhe për të shkruar propozim-kërkesa sipas statuteve të Unia-s kanë: Regjionet (dhe seksionet përmes regjioneve të tyre); Sektorët (dhe degët përmes sektorëve të tyre); Grupet e interesit; Mbledhja e dele-



gatëve; Kryesia qendrore (Bordi) dhe Drejtoria qendrore (Menaxhimi). Aplikimet dhe kërkesa-propozimet duhet të paraqiten me shkrim deri më 30 qershor 2016, ndërsa propozimet zgjedhore deri me 26 korrik 2016.

➔ Daniel Bühler

A je edhe ti kujdestare? CareInfo.ch planifikon aktualizimin e platformës së saj informative dhe dëshiroj që të merre parasysh preokupimet e rëndësishme dhe sugjerimet e kujdestareve. Nëse ti punon si kujdestare, bëhu pjesë e anketës së CareInfo.ch në: de.surveymonkey.com/r/FQPNWQ7

Shembull i pjesëmarrjes aktive në jetën politike e shoqërore në Zvicër

Kundër Iniciativës diskriminuese e poshtëruese

Të mërkurën më 3 shkurt 2016 në St. Gallen u mbajt një takim me pjesëtarë të komunitetit shqiptar i organizuar nga Komiteti mbështetës i kandidatëve shqiptaro-zviceran për Parlamentin Kantonal St. Gallen. Ka më se një vit që falë veprimtarëve veteran shqiptar të prirë nga koordinatori i fushatës, Agush Buja, pjesëmarrja e komunitetit tonë në proceset e jetës politik e shoqërore është për çdo lakmi dhe mund të shërbejë si model e shembull për organizimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit shqiptar jo vetëm për rajonet tjera të Zvicrës, por edhe më gjerë nëpër vendet tjera ku jeton e vepron diaspora jonë.

Kandidatët shqiptarë për në Parlamentin e Kantonit të St. Gallenit, nga rrethi zgjedhor St. Gallen, Isuf Sherifi, Jona Xhemajli nga SP e Veton Rasaj nga CVP, rrethi zgjedhor Rorschach, Adelina Muhagjeri, rrethi zgjedhor Wil, Arber Bullakaj kanë realizuar takim me mbështetësit e

tyre përmes organizimit të një tryeze debutuese mbi aktualitetin politik në Zvicër. Në tubim morri pjesë edhe Osman Osmani, nënkryetari i migrantëve të organizuar në kuadër të Partisë Socialdemokrate (SP) në nivel të Zvicrës dhe njëherazi sekretar nacional për migracion në sindikatën

UNIA, iniciues i komitetit mbipartiak shqiptaro-zviceran kundër votimit të Iniciativës mbi zbatim-dëbimit që ishte tema kryesore e takimit për zgjedhjet e 28.2.2016. Sipas radhës u prezantuan dhe prononcuan të gjithë kandidatët dhe së bashku me votuesit prezent e mbështetësit e tyre në fushatë u përqendruan në votimin kundër iniciativës dhe pasojat në rast të aprovimit të saj. U apela tek shqiptaro-zviceranët që të shfrytëzojnë të drejtën për të votuar kundër kësaj nisme diskriminuese e poshtëruese si dhe për kandidatët shqiptaro-zviceranë, duke u dhanë sqarime të nevojshme edhe si të votohet.

Prezantimi i kandidatëve shqiptaro-zviceran

Krahas diskutimit me të pranishmit mbi nevojën e mobilizimit për të votuar kundër iniciativës në fjalë u diskutuan edhe mundësitë e mbështetjes sa më të madhe për të votuar kandidatët shqiptaro-zviceran, që ishin pjesëmarrës të tryezës kundër nismës në fjalë. Më poshtë po portretizojmë shkurtë kandidatët pjesëmarrës të këtij paneli:



Pjesëmarrësit në debatin kundër nismës mbi zbatim dëbimit

Osman Osmani
Sekretar nacional për migracion në Unia



Veton Rasaj, është vetëm 19 vjeçar dhe është kandidat i Partinë e Demokratëve Krisitian, (CVP-PDC), të kantonit të St. Gallenit. Vetoni është kryetar i të rinjve të kësaj partie në Rorschach dhe ishte kandidat në zgjedhjet nacionale të vitit e kaluar. Vetoni angazhohet për vlerat e Partisë së tij dhe e ketë kontekst edhe për çështjet e familjes si dhe për ruajtjen e sistemin arsimor dual të Zvicrës, të tillë siç është tani. Gjithashtu angazhohet për të drejtat edhe të migrantëve dhe komunitetin tonë dhe në ketë kuadër lufton edhe Nismën famëkeqe mbi zbatim të dëbimit.



Arbër Bullakaj, aktualisht është parlamentar në qytetin e Wilit (Will SG), në të cilën zonë zgjedhore edhe kandidon për parlamentin kantonial të St. Gallen-it. Është themelues i strukturës së migrantëve socialdemokrat në Kanton të St. Gallen-it. Në zgjedhjet e fundit nacionale, ai me mbi 17 mijë vota të fituara, ishte kandidati më i preferuar i migrantëve si dhe i komunitetit tonë. Posedon përvojë të spikatur në fushën e financave. Arbëri angazhohet edhe më tej për barazi gjinore dhe shanse të njëjta për të gjithë. Gëzon mbështetje e përkrahje në Partisë Socialdemokrate edhe në nivel nacional, strukturat e së cilës kanë përgëzuar organizimin e suksesshëm të fushatës zgjedhore me përfshirje të gjerë të shqiptaro-zviceranëve.




Adelina Muhagjeri, kandidon në zonën zgjedhore të Rorschach-ut. Adelina është bashkëthemeluese e strukturës së migrantëve socialdemokrat për Kanton të St. Gallen-it. Nga kjo strukturë është e deleguar në kryesinë e zgjeruar të migrantëve socialdemokrat në nivel Zvi-

cre. Adelina vlerësohet si urë lidhëse mes gjeneratash deh kulturash. Është e integruar mirë si në kuadër të komunitetit tonë të regjionit ashtu edhe në rrjedhat shoqërore vendase. Angazhohet për të drejtat e grave dhe migrantëve, si dhe për qasje më të lehtë në tregun e punës për ta. Pastaj për një politikë favorizuese për familjet me fëmijë. Në zonën zgjedhore ku ajo garon, ka shumë votues me prejardhje shqiptare, andaj shanset e saja për të fituar mandatin e deputetes në Parlamentin e Kantonit St. Gallen konsiderohen të mira.



Isuf Sherifi, veprimtar i mirënjohur i komunitetit shqiptar, ku njihet edhe si njeri i letrave, është kandidat i zonës zgjedhore të St. Gallen-it. Në vitet e fundit është shumë aktiv edhe në jetën politike e shoqërore të Zvicrës lindore. Ai gëzon përkrahje të fuqishme nga migrantët socialdemokrat të Kantonit të tij dhe të shqiptarëve të St. Gallen-it me rrethinë. Angazhimi i tij aktual është përqendruar në mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave njerëzore të të gjithë banorëve të Zvicrës, pra edhe të migrantëve dhe të refugjatëve. Ky angazhim shprehet mjaft mirë në luftimin e iniciativës famëkeqe «për zbatim të dëbimit», ku Isufi është treguar i palodhshëm. Angazhimi i tij i pandërprerë dhe mbështetja e madhe që gëzon edhe nga komuniteti ynë me të drejtë vote premtojnë të sigurojnë atij mandatin e deputetit kantonial!



Jona Xhemajli, është gjithashtu kandidat e socialdemokratëve në zonën zgjedhore të St. Gallen-it. Ajo angazhohet për bashkëpunim mes të rinjve me sfond të huaj dhe atyre vendës, si dhe për zhvillimin e sistemit arsimor përfshirë këtu arsimimin politik edhe të rinisë. Ajo edhe pse e lindur në Zvicër (Biel/Bienne) pas luftës bashkë e prindërit e saj (i ati i saj një ish i arratisur politik i mirënjohur) janë kthyer për të jetuar në Kosovë, ku edhe ka mbaruar studimet për gazetari. Tani e sa vite Jona është kthyer për të jetuar përsëri në Zvicër, ku ka vendosur të angazhohet edhe politikisht.



I papunë: Ku duhet të lajmërohem?

Firma, tek e cila unë punoj me vite të tëra, do të mbyllet. Unë dhe të gjithë kolegët e mijë i humbim vendet tona të punës. Me rastin e informimit të punonjësve punëdhënësit tanë na kanë preferuar që sa më parë që është e mundur të lajmërohemi si të papunë. Përderisa në deri më tani asnjëherë nuk kam qenë i papunë, nuk e di se ku duhet të lajmërohem dhe se kush në të vërtetë paguan kompozimin e papunësisë. Si duhet të veproj?

Lajmërimin duhet bërë varësisht nga Kantonin në komunën në të cilën banoni ose tek enti regional i ndërmjetësimit të punës (RAV). Në faqen e internetit www.ch.ch/de/arbeitslosigkeit-anmelden mund të shihni se ku duhet të lajmërohemi. Me këtë rast ju aty duhet të shënoni vetëm numrin postës së vendbanimit tuaj. Pasi vlen obligimi që duhet të përpiqeni për gjetjen e vendit të punës para të qenit pa punë (p.sh. qysh gjatë afatit të shkarkimit nga puna, gjegjësisht që nga data që u është komunikuar shkarkimi) është veçanërisht me rëndësi, që menjëherë të vihen në kërkim të një vendi të ri të punës dhe që përpjekjet gjegjëse të ruani (shkresat e aplikimit, konkurset e punës, e-mailat, të dhënat mbi telefonatat apo bisedat personale aplikative, etj). Sa përket lajmërimit, është me rëndësi, që më së voni nga dita e parë e papunësisë suaj, të lajmërohemi personalisht tek RAV-i. Kështu mënjanoi shkurtesat e gjობat me rastin e kompensimit të papunësisë. Sa i përket përgjegjësisë: Në parim RAV-i kujdeset për këshillimin dhe ndërmjetësimin e të papunëve. Këshilltarja apo këshilltari i RAV ju mbështet dhe shoqëron për gjetjen e vendit të përshtatshëm të punës. Pagesa e kompensimit të papunësisë kryhet përmes arkës së sigurimit të papunësisë.

Timur Öztürk, work, 21.1.2016, (version i përshtatur)

Vend i ri pune: A mund të jap dorëheqje para se të kam filluar punën?

Unë në javët e fundit kam aplikuar për dy vende të ndryshme pune: në njërin anë tek zdrukthëtari A dhe në anën tjetër tek zdrukthëtari B. Para pak ditësh morra aprovimin nga zdrukthëtari A. E nënshkrova kontratën dhe për një muaj duhet të fillo punën aty. Në ndërkohë më ka thirrur zdrukthëtari B. e cila gjithashtu më ofroj punësimin. Me kushte më të mira pune. Andaj edhe pranova dhe e nënshkrova edhe ketë kontratë. Zdrukthëtarit A i kam shkruar se nuk do të nisi punën tek ai. A kam vepruar në mënyrë korrekte?

Në parim po. Para fillimit të punës vlejnjë rregullat e njëjta sikur në kohën e punës provuese. Dhe me këtë rast afati i dorëheqjes është 7 ditë. Andaj nuk paraqet problem dorëheqja, me kusht se këtë e bëni së paku 7 ditë para se të keni filluar punën. Në rast se për vendin e punës nuk është paraparë afati kohor provues, normalisht vlen afati njëmuajor i dorëheqjes. Në këtë rast duhet që të jepni dorëheqje së paku një muaj para fillimit të punës. Përndryshe zdrukthëtari A. ka të drejtë të kërkojë kompensim dëmi në lartësi të një çereku të pagës suaj mujore. Kjo vetëm me kushtin që zdrukthëtari A me të vërtetë mund të dëshmojë dëmin. Shembulli bie në rast se për vendin e punës që ju është dashur t'ia filloni, nuk mund të zëvendësohet me kohë. Sidoqoftë, kështu apo ashtu është e rëndësishme që, zdrukthëtarit A menjëherë pas aprovimit me zdrukthëtarin B t'ia komunikoni refuzimin e vendit të punës. Nëse pritni të kalojnë edhe ditë tjetër, zdrukthëtari A mund të kërkojë kompensim për shkak të sjelljes jo lokale.

David Aebly, work, 17.12.2015

Impressum: **Bellage zu den Gewerkschaftszeitungen** work, area, Événement syndical | **Herausgeber** work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Social SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | **Redaktionskommission** A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sariaşlan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | **Sprachverantwortlich** Osman Osmani | **Layout** C. Lonati, Unia | **Druck** Tagblatt Print, Im Feld 6, 9015 St. Gallen | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft.
Le Syndicat.
Il Sindacato.